



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Njoftim për shpallje konkursi të brendshëm

Në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, shpallet konkurs i brendshëm, për personel ndihmësakademik me karakter administrativ. Ftohen të aplikojnë punonjësit e kategorisë personel ndihmësakademik dhe administrativ, me kohë të plotë në UE, që plotësojnë kriteret e përgjithshme e të posaçme, në respektim të rregullores në fuqi, miratuar me Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 të Senatit Akademik “Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmësakademik në Universitetin e Elbasanit ”Aleksandër Xhuvani”:

Kategoria: personel ndihmësakademik me karakter administrativ.

Njësia: Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

Pozicioni i punës: Përgjegjës i Laboratorit Eksperimental.

Përgjegjës i Laboratorit Eksperimental: është personel ndihmësakademik me karakter administrativ, i cili përgjigjet për organizimin, administrimin dhe funksionimin e laboratorit, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive laboratorike, mirëmbajtjen dhe administrimin e pajisjeve dhe materialeve laboratorike si dhe respektimin e rregullave të sigurisë në laborator. Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) në lidhje me aktivitetet e vlerësimit, akreditimit, mbikqyrjes dhe rivlerësimit. Bashkëpunon me specialistët e sektorit, Dekanin dhe të tretë si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e pozicionit. Raporton te Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës në lidhje me veprimtarinë e laboratorit.

Kandidati duhet të plotësojë këto kriteret e përgjithshme e të posaçme:

Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar dhe të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Të plotësojë kriteret e posaçme.

Kriteret e posaçme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë Master i Shkencave ose ekuivalente me të, në Kimi Industriale dhe Mjedisë/ Inxhinieri Kimike. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- Të ketë jo më pak se 3 (tri) vite përvojë pune në laborator;
- Të ketë njohuri dhe përvojë në përdorimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e pajisjeve dhe instrumenteve laboratorike;
- Të ketë njohuri dhe përvojë në përgatitjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit teknik dhe të cilësisë së laboratorit;
- Të ketë njohuri mbi rregullat e sigurisë dhe procedurat e punës në laborator;
- Të ketë kualifikime dhe/ose trajnime profesionale brenda dhe jashtë vendit, të vërtetuara me dokumentacion në fushat përkatëse;
- Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj, të vërtetuar me dokumentacion;
- Të ketë njohuri mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe kërkesat e akreditimit të laboratorëve;
- Të ketë aftësi të mira, organizative, menaxhuese dhe komunikuese e të punës në grup dhe për të bashkëpunuar me strukturat drejtuese, personelin akademik dhe palë të treta.

Kandidatët e interesuar, në respektim të pikës **d** dhe **e** të nenit 6 “Konkursi i brendshëm” të Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 “Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmës akademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të Senatit Akademik, duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e shpalljes në www.uniel.edu.al (14.09.2026 deri datë 16.09.2026) dokumentacionin si më poshtë:

- Letër interesi
- Dokumentacion shtesë, veç atyre që ndodhen në dosjen personale.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në protokollin e Institucionit.

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht kërkesat dhe dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (18.09.2026 – 25.09.2026). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.